

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



JANAR



Nderohet me homazhe heroit Ismail Luma-Altini

Me rastin e 26-vjetorit të rënies heroike të Ismail Luma-Altinit, Nënkyetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bëri homazhe dhe vendosi buqeta me lule pranë lapidarit të heroit në shkollën Ismail Luma, si shenjë respekti dhe mirënjohjeje për veprën e tij të pavdekshme.

Nënkyetari Bytyqi theksoi se veprat dhe sakrificat e dëshmorëve, si Ismail Luma-Altini, përbëjnë themelin mbi të cilin qëndron liria jonë. Nderimi i tyre është një detyrim kombëtar dhe moral.

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve!



Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Ismail Luma" ka organizuar program artistik në kuadër të Ditës së Shkollës dhe 26-vjetorit të rënies heroike të heroit kombëtar Ismail Luma-Altini.

Gjatë këtij aktiviteti, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vlerësoi punën e palodhshme të stafit arsimor dhe theksoi rolin e arsimit në ruajtjen e figurave historike të kombit.

"Liria që gëzojmë sot është rezultat i sakrificës sublimë të heronjve si Ismail Luma. Ky hero na mëson se vetëm përmes përkushtimit dhe guximit mund të ndërtojmë një të ardhme të lirë dhe dinjitoze. Është detyrë e jona të edukojmë brezat e rinj që të çmojnë këtë liri dhe të ruajnë me krenari vlerat që e bëjnë të fortë një komb", tha Kryetari Ahmeti.

Drejtori i shkollës, z. Driton Sadiku, gjithashtu shprehu mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij programi, duke nënvizuar rëndësinë e përfshirjes së kujtesës historike në procesin edukativ.

Programi u pasurua me performanca artistike nga nxënësit, duke përfshirë këngë, recitime dhe pjesë teatrale, të cilat ilustruan me mjeshtëri rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe përkushtimin ndaj vlerave historike.


Lipjani performon jashtëzakonisht suksesshëm në realizimin e të hyrave vetanake



REALIZIMI I BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ka tejkaluar planifikimin për të hyrat vetanake, duke realizuar **3,571,011.69** euro nga 2,532,006 euro të planifikuara, një rritje prej **41.03%** ose **1,039,005.69** euro më shumë.

Menaxhimi i buxhetit ka dëshmuar një performancë të lartë në realizim, me shpenzime prej **24,821,501.00** euro nga 25,421,058.48 euro të planifikuara, që përbën **97.64%** të realizimit.



Komuna e Lipjanit ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm në menaxhimin e të hyrave vetanake për vitin 2024, duke tejkaluar ndjeshëm planifikimin. Nga 2,532,006 euro të planifikuara, janë realizuar plot 3,571,011.69 euro, duke shënuar një rritje mbresëlënëse prej 41.03%, ose 1,039,005.69 euro më shumë se pritshmëritë.

Gjithashtu, menaxhimi i buxhetit ka dëshmuar një performancë të lartë në realizim, duke shpenzuar 97.64% të buxhetit të planifikuar. Konkretisht, janë shpenzuar 24,821,501.00 euro nga 25,421,058.48 euro të planifikuara.



Kryetari Ahmeti mirëpret talentet e futbollit që do të përfaqësojnë Komunën e Lipjanit në Barcelonë, Spanjë

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me Drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Anila Reçica Llugini, kanë pritur në takim talentet e rinj të futbollit nga komuna jonë, të cilët janë përzgjedhur për të marrë pjesë në "FC Barcelona Football Clinic" në Barcelonë, Spanjë.

Kryetari Ahmeti u shpreh i lumtur për sukseset e të rinjve të Lipjanit, të cilët kanë dëshmuar talente të jashtëzakonshme në garat sportive.

"Përkushtimi ynë për të mbështetur të rinjtë dhe zhvillimin e tyre do të jetë i vazhdueshëm. Këta të rinj janë shembulli më i mirë i punës, disiplinës dhe talentit që ekziston në komunën tonë. Lipjani do të vazhdojë të jetë përkrahës i fuqishëm i sportit dhe i mundësive që fuqizojnë gjeneratat e reja", tha Kryetari Ahmeti. Ndërsa prindërit dhe përfaqësuesit e shkollës së futbollit shprehën mirënjohjen e tyre ndaj Kryetarit Ahmeti për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkushtimin e tij në promovimin e talentëve të rinj dhe zhvillimin e sportit në përgjithësi.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 33-të me radhë



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, sot ka mbajtur mbledhjen e 33-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, përveç pikave të parapara për këtë mbledhje, prezantoi edhe një pikë shtesë për diskutim në këtë mbledhje.

Ndërsa, anëtarët e KPF-së pas diskutimeve të bëra gjatë këtij takimi aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të martën, më 28 janar 2025.



U mbajt mbledhja e 38-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 38-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës dhe një pikë shtesë, të propozuara për këtë seancë.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508